



E ardhmja e Adnan Januzaj është e paqarte. Kompani të ndryshme bastesh duke parë interesimin e madh që sjell kjo ceshtje e kanë përfshirë lojtarin në lojrat që ofrojnë. “Sky Bet” ka hapur bastet se për cilën kombetare do të luaj Adnan Januzaj. Kuotat e vendosura favorizojnë Shqipërinë. Në vend të dytë që ka më shumë shanse që t’i bashkohet 18-vjeçari i Manchester Junajtid është Belgjika. Turqia dhe Serbia janë dy vendet e tjera që kuotohen përveç Anglisë, për të cilën duhet të qëndrojë 5 vjet në këtë vend për t’ia bashkuar kombëtares së tre luaneve. I riu që ka mundësi për të luajtur me disa kombetare ka refuzuar deri tani të luajë për të rinjtë e Belgjikës.